

tek dorës
auditit



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I TIRANËS
BORDI I ADMINISTRIMIT

Nr. 1678/prot
2

Tiranë më 28.9.2022

VENDIM

Nr. 49 datë 23.09.2022

“PËR MIRATIMIN E PROJEKT RAPORTIT TË AUDITIMIT REALIZUAR
PRANË FAKULTETIT TË EKONOMISË TË UT“

Në mbështetje të neneve 3 pika 3/c, 47, 49 e në vijim të Ligjit nr.80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, neneve 8, 14, e në vijim të Ligjit nr.114/2015 “Për auditimin e brendshëm në Sektorin Publik”, neni 12 “Përgjegjësia e titullarit të njësisë publike”, bazuar në planin vjetor 2022, për Drejtorinë e Auditimit të Brendshëm të UT, miratuar me Vendimin nr.41, datë 25.10.2021, të Bordit të Administrimit të Universitetit të Tiranës,

VENDOSI:

1. Miratimin e Projekt Raportit të auditimit me objekt “*Auditim i përputhshmërisë dhe financiar*” të aktivitetit të Fakultetit të Ekonomisë të Universitetit të Tiranës, për periudhën 01.01.2019 deri më 31.12.2021, realizuar në zbatim të programit të auditimit nr.prot. 1678/1, datë 07.06.2022 “Për angazhimin e auditimit për Fakultetin e Ekonomisë të Universitetit të Tiranës”,
2. Ky Projekt Raportit i përcillet zyrtarisht Fakultetit të Ekonomisë të Universitetit të Tiranës për njohje dhe paraqitje observacionesh.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

